



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë

ëëë.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: E Drejta Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	viti i I -të, semestri i 2 -të
Numri i orëve në javë:	2 ligjerata + 2 ushtrime
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Ligjërata: 10:00-12:00; 12:00-14:00 Ushtrime: Asistent:
Mësimdhënësi i lëndës:	Besfort Rrecaj
Detajet kontaktuese:	besfort.rrecaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë ka për qëllim parësor që të ofrojë një studim të rendit publik ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Si struktura institucionale, ashtu dhe korniza ligjore në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe mekanizmat për zbatimin e kësaj kornize, -- duke përfshirë këtu dhe një analizë kritike të përshtatshmërisë së strukturës aktuale institucionale dhe zbatuese, -- paraqesin thelbin e përmbajtjes dhe të interesimit të kësaj lënde. Përveç hetimit të kornizës ligjore dhe institucionale të Kombeve të Bashkuara dhe të sistemeve rajonale për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, kjo lëndë po ashtu synon ekzaminimin e zhvillimit të diskursit dhe lëvizjes për të drejtat e njeriut, veçanërisht nga viti 1945.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e tjera të lëndës kanë të bëjnë me analizën dhe shqyrtimin e dispozitave, rasteve, standardeve dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut, si dhe masave në dispozicion kundër këtyre shkeljeve në sistemin aktual ndërkombëtar dhe në sistemet rajonale të të drejtave të njeriut. Përfundimisht, struktura e kësaj lënde është e organizuar në një mënyrë që në thelb përfshinë tri kategori kryesore, dhe ka për qëllim: (1) Së pari, të ofrojë një hyrje konceptuale për të

	drejtat e njeriut; (2) së dyti, të paraqesë dimensionin institucional të sistemit ndërkombëtar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, dhe (3) së treti, të analizojë dhe studiojë çështje, raste dhe të drejta specifike të njeriut.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët janë në gjendje të: 1. Kuptojnë dhe shpjegojnë origjinat intelektuale, kuptimin dhe zhvillimin e diskursit dhe të lëvizjes së të drejtave të njeriut; 2. Kuptojnë dhe shpjegojnë sistemin aktual botëror të të drejtave të njeriut, si burimet ashtu dhe institucionet dhe instrumentet kryesore ligjore në fuqi; 3. Kuptojnë dhe shpjegojnë sistemet rajonale për të drejtat e njeriut, veçanërisht sistemin evropian të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut; 4. Njohin dhe përdorin procedurat e përdorura për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si në nivel të Kombeve të Bashkuara ashtu dhe në nivel rajonal; 5. Njohin dhe kuptojnë aspekte specifike të të drejtave të njeriut, si për shembull të drejtën në jetë dhe të drejtën në gjykim të drejtë, të drejtat e pakicave, të drejtën për vetëvendosje, ndalimin e diskriminimit, mbrojtjen e refugjatëve, të drejtën e azilit, të drejtat e njeriut në konflikte të armatosura, si dhe sfidat në realizimin e këtyre të drejtave; dhe 6. Përdorin dhe analizojnë raste dhe dokumente ligjore në kontekst të problemeve konkrete në botën reale.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15 javë	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15 javë	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	2 ditë	4
Kollokfume,seminare	5	2 javë	10
Detyra të shtëpisë	1	10 javë	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15 javë	30
Përgatitja përfundimtare për provim	7	5 ditë	35
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	2 ditë	4
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	5	3 ditë	15

Totali			168
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënies që do të përdoret në zbatimin e programit të kësaj lënde mbështetet në analizën e thellë të materialeve të përzgjedhura sipas udhëzimit të profesorit të lëndës. Studentët duhet të ballafaqohen me problemet e jetës së përditshme të hulumtimit dhe interpretimit, të zgjedhura midis atyre më të shpeshta dhe tipike në proceset vendimmarrëse dhe të ligjbërjes ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, me prioritet ndaj atyre që kanë ose mund të kenë një korrelacion më të përafërt me përvojat dhe nevojat në Kosovë. Me fjalë të tjera, nuk do të prezantohen vetëm rregullat themelore në burimet e përshkruara, por problemet më të shpeshta që shfaqen gjatë aplikimit të tyre, për të ndriçuar strukturën e tyre dhe problemet interpretuese që lidhen me to. Do të bëhet, gjithashtu, <i>përpyetje</i> për një ekuilibrim të përhapjes së njohurisë mbi tiparet kryesore të sistemit institucional ndërkombëtar dhe nocioneve më të specializuara, ndonëse orientimi parësor do të jetë—i motivuar nga filozofia udhëheqëse në këtë rast—se njohuria bazë mund të përftohet lehtë si derivat i diskutimit të përqendruar në probleme të specializuara, përparësia e të cilës empirikisht qëndron në një shkallë më të lartë probabiliteti të ngritjes apo rritjes së aftësisë ose shkathtësisë dhe kapacitetit për të zotëruar nocione më specifike dhe për të vepruar në kontekste më praktike. Me qëllim të përgatitjes sa më të mirë, kërkohet që paraprakisht të lexohen materialet për temën e cila diskutohet në orën(-t) pasuese, për të krijuar një kuptim të përgjithshëm dhe familjarizim me materialin dhe tërësinë e ndryshueshmërinë e temave që do të diskutohen në ligjërata.		
Metodat e vlerësimit:	Testi i parë: 40 pikë Testi i dytë: 50 pikë Detyrat e shtëpisë: pikë (detyra x pikë) Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 10 pikë Provimi përfundimtar: 100 pikë Totali: 100 pikë. Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90 = 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese. <i>* vërejtje: Provimi përfundimtar organizohet për studentët të cilët nuk kanë</i>		

	<i>arritur prapun e kalueshmërisë në testin e parë dhe të dytë ose që nuk janë të kënaqur me rezultatin e arritur gjatë atyre testeve.</i>
Literatura	
Literatura bazë:	• ZEJNULLAH GRUDA, MBROJTJA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERIUT I (UNIVERSITETI I PRISHTINËS: PRISHTINË, 2013)
Literatura shitesë:	• ZEJNULLAH GRUDA, E DREJTA NDËRKOMBËTARE PUBLIKE (UNIVERSITETI I PRISHTINËS, PRISHTINË, 2013) – PJESA QË NDËRLIDHET ME MBROJTJEN NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT • DR. GENTIAN ZYBERI, E DREJTA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERIUT (BOTART 2011) • RAIJA HANSKI DHE MARKKU SUKSI, HYRJE NË MBROJTJEN NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT (INSTITUTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, UNIVERSITETI I ABO AKADEMISË, 1999). • PËR NJË REND PUBLIK EUROPIAN (VENDIME TË ZGJEDHURA TË GJYKATËS EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT, VËLLIMI I; TIRANË, 2001). • RASTET KRYESORE TË KOMITETIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT (PËRMBLEDHUR NGA RAIJA HANSKI DHE MARTIN SCHEININ, 2003). • DR. GENTIAN ZYBERI, E DREJTA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERIUT (BOTART 2011)
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	HYRJE & KUPTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT - Përmbajtja, organizimi dhe kërkesat e lëndës; metodologjia e mësimdhënies; dhe metoda e vlerësimit ORIGINAT DHE KUPTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT
<i>Java e dytë:</i>	BURIMET E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
<i>Java e tretë:</i>	TË DREJTAT E NJERIUT NË RENDIN JURIDIK TË KOSOVËS
<i>Java e katërt:</i>	SISTEMI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E NJERIUT: INSTRUMENTET DHE INSTITUCIONET
<i>Java e pestë:</i>	“KARTA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE”: DEKLARATA UNIVERALE DHE PAKTET PËR TË DREJTAT E NJERIUT
<i>Java e gjashtë:</i>	SISTEMET RAJONALE TË MBROJTJES DHE PROMOVIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT: SISTEMI EVROPIAN I TË DREJTAVE TË NJERIUT
<i>Java e shtatë:</i>	PROVIMI MES-SEMEMSTRAL
<i>Java e tetë:</i>	E DREJTA NË JETË DHE E DREJTA NË GJYKIM TË DREJTË
<i>Java e nëntë:</i>	LIRIA E SHPREHJES, LIRIA E MENDIMIT, E NDËRGJEGJES DHE E FESË, DHE E DREJTA E PRIVATËSISË

<i>Java e dhjetë:</i>	E DREJTA NË PRONË DHE LIRIA E TUBIMIT DHE E ORGANIZIMIT
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	MBROJTJA E PAKICAVE
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	E DREJTA E VETËVENDOSJES
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	NDALIMI I DISKRIMINIMIT
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	MBROJTJA E REFUGJATËVE DHE E DREJTA E AZILIT
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	TESTI I DYTË MES-SEMESTRAL (PËR STUDENTËT QË E KANË KALUAR TESTIN E PARË MES-SEMESTRAL) PROVIMI PËRFUNDIMTAR

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Vijueshmëria në ligjerata dhe ushtrime është obligative për të gjithë studentët e rregullt, përveq rasteve të arsyeshme të mungesës së raste të caktuara. Qetësia gjatë orës së ligjeratës apo ushtrimeve është esenciale në suksesin e lëndës andaj studentët duhet të mbajnë qetësinë në nivelin e duhur. Interaktiviteti gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve është pjesë e rëndësishme e mësimdhënies dhe të gjithë studentët janë të inkurajuar që të marrin pjesë në mënyrë aktive. andaj studentët të cilët kërkojnë që të inkuadrohen dhe të japin mendimin e tyre në lidhje me temat e caktuara në kuadër të syllabusit të kësaj lënde mund të ngrisin dorën për të marrë fjalën. Kontakti me profesorin apo asistentin e lëndës mund të zhvillohet gjatë orëve të konsultimeve ose përmes emailit zyrtar.